



Projekti: MASAT E EFIÇIENCËS SË ENERGIJË NË SEKTORIN REZIDENCIAL - SHITËPITË INDIVIDUALE

## **SHTOJCA 1. UDHËZIME PRAKTIKE PËR ZBATIMIN E DETYRIMEVE TATIMORE DHE PROCEDURAVE TJERA PLOTËSUESE**

Emri e mbiemri, dhe numri personal i Përfituesit: Besart Zeka, 1174512821

*Sqarime për tatimpaguesit/operatorët tregtar dhe punëkryesit:*

Bazuar në referencën e ATK-së nr. E-27/2023 të datës 24.08.2023, FKEE ofron sqarimet si më poshtë:

- (1) Të gjithë përfituesit e subvencioneve për masat e Eficiencës së Energjisë lirohen nga pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Lirimi nga TVSH bëhet për tërë vlerën e projektit, pavarësisht vlerës së financuar nga Komisioni Evropian. Pra, të gjitha investimet lidhur me Projektin, në tërësi konsiderohen të liruara nga pagesa e TVSH-së. Lirimi i TVSH-së bëhet vetëm për shumën e para aprovuar nga KEEF prej 9,370.70 €.
- (2) Lirimi prej TVSH-së duhet të bëhet direkt, pra me rastin kur kontraktohen punimet apo bëhet faturimi për blerje të mallrave, atëherë operatori kontraktues i regjistruar në TVSH nuk duhet ta llogarit TVSH-në, por duhet të faturoj pa TVSH (për përfituesin si individ) dhe në faturat e tyre të shkruajnë referencën ligjore: *"Faturimi në bazë të nën-paragrafit 3.1, paragrafi 3 i nenit 33 të Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar"*.

*Përfituesit e subvencioneve pas përfundimit të punimeve duhet t'i sjellin këto dokumente për dëshmi të pagesave në FKEE:*

- Faturën nga kompania punëkryese, e cila ka implementuar masat EE.
- Të gjitha pagesat duhet të procesohen përmes bankës dhe një kopje e pagesave i dorëzohet FKEE-së. FKEE nuk do t'i merr në konsiderim pagesat e kryera me kesh apo në forma tjera.

**Shënim:** Kjo letër mund të shfrytëzohet për qëllime/lehtësime tatimore, prandaj përfituesit dhe operatorët kontraktues - bizneset janë të obliguara t'u përmbahen udhëzimeve të mësipërme dhe të mos manipulojnë me shumën përtej shumës së përcaktuar në nenin 1. Në të kundërtën, pasojnë masat ligjore.